

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

23.10.2024
Ora, 17:16

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve” (vijon).

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**


- | | | |
|------------|-------|------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Jona Josifi, Elona Demollari |

Parti Politike: PSSH (E. Xhina)

OJQ: S’ka prezent!

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje kemi një çështje në rendin e ditës për të shqyrtuar. Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretaria e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së, përfaqësues të partive politike. Sikundër njoftuam në mbledhjen e ditës së hënë nga ana e Komisionerit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Shtetëror të Zgjedhjeve na është paraqitur një draft i ri i projektvendimit. Pra, u tërhoq drafti që diskutuam në mbledhjet pararendëse dhe kemi një draft të ri. Gjatë kësaj periudhe dy ditore, Komisioni Rregullator ka zhvilluar një veprimtari të dendur konsultimi brenda vetes, me administratën dhe me subjekte të tjera të interesuara, përfshi parti politike. Në këtë moment, ne do të nisim me shqyrtimin e draftit të ardhur nga Komisioneri, më tej kolegët kanë propozime për krerë të të veçantë dhe unë do të citoj i kujt është propozimi dhe do të lexoj tekstin për shqyrtim. Jeni dakord paraprakisht me këtë procedurë? Nga administrata, nuk besoj se do të ketë nevojë për ndonjë diskutim paraprak, për shkak se siç ju thashë konsultimi është bërë gjerësisht nga ana e anëtarëve të komisionit, për të arritur në një vendimmarrje e cila do të mundësonte fillimin e procesit të shumëpritur, le të themi, për votimin e shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut. Ky, sikundër e kemi theksuar është akti i parë, shumë i rëndësishëm.

Atëherë kolegë, për procedurë po ju pyes, nëse keni çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar, keni? Nuk keni! Gjithashtu për procedurë, edhe pse ne, para disa ditësh, një jave e kemi votuar në parim, kemi votuar një draft tjetër. Tani kemi një draft të ri dhe unë do t'ju ftoja, nëse keni diskutime në parim, i bëjmë? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim, si mendoni? Në parim, besoj jemi shprehur të gjithë për rëndësinë e këtij akti, kështu që unë po kaloj në votimin në parim të projektvendimit "Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve". Kolegë!

Kush është dakord në parim?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Fillojmë me shqyrtimin nen për nen. Sa i përket përmbajtjes së aktit ai është i ndarë në krerë. Do ta nis me Kreun I, që janë “Parime të përgjithshme”. Për këtë kre, me sa kemi biseduar mes kolegëve nuk kemi propozime të tjera. Kështu që më duhet të lexoj propozimin e ardhur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kreu I. Parime të përgjithshme.

1. Parimi i transparencës: Procesi i regjistrimit dhe votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jetë i hapur dhe i monitoruar në mënyrë që të garantohet informimi i duhur i publikut dhe subjekteve zgjedhore mbi çdo hap të procedurave.
2. Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë: Procedurat e regjistrimit dhe të votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jenë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar e ndjekur nga zgjedhësit, duke minimizuar barrën administrative e teknike, si dhe me kosto sa më të ulët për zgjedhësin.
3. Parimi i efektshmërisë: Procedurat për regjistrimin dhe votimin nga jashtë vendit duhet të jenë efektive, duke synuar që vota e çdo shtetasi të realizohet në kohë dhe pa pengesa të panevojshme.
4. Parimi i gjithpërfshirjes dhe aksesit të barabartë: Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, pavarësisht vendndodhjes së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë mundësi të barabarta për të votuar.
5. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda kufijve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.


Atëherë, për Kreun I, kemi diçka kolegë?

Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!


Kreu II. Rregulla të përgjithshme.

Për këtë kre, ka bërë një propozim zonja Vukaj bashkë me zotin Çakaj, që e kanë riformuluar kreun, kështu që mua më duhet ta lexoj. Atëherë,

Kreu II. Rregulla të përgjithshme.

1. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin nga atje ku ndodhet, duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.
2. Regjistrimi i zgjedhësit në listën e zgjedhësve jashtë vendit bazohet në vullnetin e vetë zgjedhësit për ta ushtruar të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast është zgjedhësi ai që duhet të plotësojë kushtet ligjore për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohen në këtë vendim apo në akte të tjera rregullatore të votimit nga jashtë, pavarësisht faktit se emri i tij është në listën përfundimtare të zgjedhësve.
3. Regjistrimi në listën e zgjedhësve jashtë vendit passjell çrregjistrimin e tij nga lista e zgjedhësve që votojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Nëse zgjedhësi i regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve jashtë vendit, deri në ditën e fundit të përfundimit të afatit për miratimin e kësaj liste konstaton se nuk mund ta ushtrojë të drejtën e votimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për shkaqe të përligjura, siç parashikon Ligji Zgjedhor., më lejoni të them Kodi Zgjedhor, këtu? ... siç parashikon Kodi Zgjedhor, ky vendim, apo akte të tjera rregullatore mbi votimin nga jashtë, atëherë ai ka të drejtën që edhe nëpërmjet PER të kërkojë të ripërfshihet në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit brenda

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

vendit në të cilën ishte regjistruar përpara shpalljes së listës perfundimtare të zgjedhësve të parashikuar sipas Kodit Zgjedhor. Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, nga këtu e vijim referuar si zgjedhësi, realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit dhe regjistrimin e tyre jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të këtij procesi.


6. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë paraqet në mënyrë individuale kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Afati për paraqitjen e kërkesës fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë para kësaj date.

7. Kërkesa kryhet përmes llogarisë që zgjedhësi krijon në Platformën Elektronike të Regjistrimit, nga këtu e në vijim në këtë vendim referuar si “PER” e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. PER duhet t’i përcjellë sqarime zgjedhësit në lidhje me procedurat e regjistrimit në listën e zgjedhësve jashtë vendit, si dhe mbi kushtet e kriteret për ushtrimin e të drejtës së votës nga jashtë vendit. Karakteristikat e përgjithshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithshme të përdorimit të tij përcaktohen me akt të KQZ-së. Në çdo rast struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procedurave përcakton specifikimet teknike për prokurimin e PER.

8. PER është e aksesueshme pa pagesë për zgjedhësin. Zgjedhësit do t’i jepet mundësia ta shkarkojë këtë platformë si në versionin desktop, ashtu edhe në atë mobile pa qenë i kushtëzuar nga lloji i pajisjes elektronike që do të përdorë.

Pra, lexova Kreun II, të riformuluar për këtë kre. Kolegu Çaka, më ka kërkuar të bëjë një ndërhyrje. Po, Zoti Çaka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. D. Çaka: Po, faleminderit zonja Nano! Duke pasur parasysh që jemi duke shqyrtuar një propozim të kolegëve Vukaj dhe Çakaj, në lidhje me këtë kre, pra, “Rregulla të Përgjithshme”, dua të them që parimisht e shpreh një dakordësi timen me përmbajtjen e këtij propozimi, por do të doja të propozoja një ndryshim në pikën 7 të këtij kreu. Kolegët kanë propozuar, po përmend dy fjalitë e fundit, të cilat unë kërkoj...

Znj. I. Nano: Paska qenë dhe në draftin e mëhershëm.

Z. D. Çaka:... Po, “Karakteristikat e përgjithshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithshme të përdorimit të tij përcaktohen me akt të KQZ-së. Në çdo rast struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procedurave përcakton specifikimet teknike për prokurimin e PER”. Dua të theksoj se ne si Komision Rregullator, Kodi Zgjedhor na ka përcaktuar detyra të qarta dhe të sakta në lidhje me aktet rregullative të cilat ne duhet të normojmë. Ajo pjesë e Kodit Zgjedhor në ndryshimet e pësuar në korrik 2024 në lidhje me votën e votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, apo PER-in dhe çdo procedurë që lidhet, po themi, me këtë aplikacion, në vlerësimin tim nuk ka autorizuar për të qenë ne, struktura përkatëse për të miratuar karakteristikat teknike, apo elementë të tjerë specifikë. Ndryshe nga raste të tjera, pra të përcaktuara në mënyrë konkrete dhe specifike në Kodin Zgjedhor. Ne të gjithë, ashtu si dhe në veprimtarinë katërvjeçare, kemi përcaktuar që kur Kodi Zgjedhor ka cituar termin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe dua të citoj nenin 25, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Ku thotë në lidhje me votën e emigrantit, konkretisht në pikën 3 që, “Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë Kod

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

nga KQZ. Pra, duhet theksuar që vlerësoj se nuk jemi ne kjo strukturë që të miratojë këto karakteristika teknike, të japim orientime në lidhje me këtë fushë. Prandaj do të doja që këtë pikë ta riformulonim, pra për pjesën e parë jam dakord. Por do të doja të bëj një propozim në lidhje me dy fjalitë e fundit, të cilat të ndryshohen dhe të zëvendësohen me një fjali të vetme me këtë përmbajtje: “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të miratojë me akt/akte parimet dhe karakteristikat për krijimin, administrimin, mbikqyrjen dhe auditimin e PER, sipas legjislacionit në fuqi”. Pra, atë kompetencë që neni 25, pika 1 ne na ka dhënë si Komision Rregullator, në këtë rast. Ndërsa pjesa tjetër komplet, pjesa e karakteristikave dhe parimet për krijimin, administrimin dhe mbikqyrjen nuk i takon kësaj strukture, faleminderit!


Znj. I. Nano: Pra, propozimi juaj është që këtu ku fillon karakteristika, pra dy fjalitë e fundit...

Z. D. Çaka: Fjalitë “Karakteristikat e përgjithshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithshme të përdorimit të tij përcaktohen me akt të KQZ-së. Në çdo rast struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procedurave përcakton specifikimet teknike për prokurimin e PER”, të zëvendësohet me fjalinë “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të miratojë me akt/akte parimet dhe karakteristikat për krijimin, administrimin, mbikqyrjen dhe auditimin e PER, sipas legjislacionit në fuqi”.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit Kryetare, në cilësinë e bashkëpropozuesit me kolegen Vukaj, së pari për saktësi edhe të Kodit Zgjedhor, por edhe të çështjeve që shtrohen


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

për diskutim në këtë mbledhje, në Kodin Zgjedhor, neni 25, parashikohet që KQZ-ja do të krijojë një platformë elektronike. Pra, nuk kemi të bëjmë me një aplikacion të thjeshtë. Kemi të bëjmë me një platformë elektronike. Propozimi ynë i sapo lexuar nga Kryetaria, ka të bëjë me procesin e mëpasshëm të auditimit të kësaj platforme elektronike. Sjell në vëmendjen tuaj dy elementë. Së pari, kjo platformë elektronike do të jetë, si të thuash, shtrati i cili do të përpunojë të gjitha të dhënat. Pra, do të presë kërkesat për regjistrim, do të përpunojë të dhënat, do të administrojë këto të dhëna të të gjithë zgjedhësve shqiptarë nga jashtë vendit. Në fund, nëpërmjet PER-it apo jo? Të më korigjojë administrata nëse e kam kuptuar gabim, do t'i kthehet përgjigje zgjedhësit, nëse kërkesa e tij për regjistrim si zgjedhës nga jashtë vendit, pra, shprehja e vullnetit të tij është miratuar, apo jo?! Sigurisht pasi plotësohen gjithë kriteret dhe kushtet ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor, që do të miratojmë edhe ne, në aktet tona rregullatore. Kjo së pari! Së dyti, është shumë e rëndësishme të theksojmë faktin që në rastin konkret kemi të bëjmë me një platformë e cila do të duhet se s'bën të rregullohet, pasi nuk do të kenë lëndë audituesit nesër, pasnesër, për ta audituar, për të kryer verifikimin. Kjo është garanci për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kjo është garanci për palët dhe është garanci si të thuash, është një mjet shterrues për të verifikuar integritetin e kësaj platforme. Pra, të mos ketë asnjë lloj mëdyshje për integritetin e kësaj platforme. Lidhur me vlerësimin tuaj, unë ndaj mendim të ndryshëm. Në gjykimin dhe vlerësimin tim ndryshimet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 26 korrik, nuk e kufizojnë në lëndë, apo materie Komisionin Rregullator, që disa akte t'i miratojë, ose disa të tjera jo. Sjell këtu për paralelizëm edhe aktet që ne kemi miratuar për përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, në vitin 2020 dhe 2021 dhe konkretisht aktet që kemi miratuar për përdorimin e PEI-it (Paisjes Elektronike të Identifikimit) dhe PEVN-së (Paisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit). Kështu që vlerësoj bashkë me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

kolegen Vukaj, ndodhemi ekzaktësisht në të njëjtat kushte. Pastaj në qoftë se këto karakteristika të përgjithshme teknike si dhe parimet dhe rregullat e përgjithshme të përdorimit do të përcaktohen me akt të Komisionit Rregullator, apo me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk ka asnjë lloj problemi për ne. Ndërsa për fjalinë e fundit, nuk ka problem e pranoj dhe propozimin tuaj, le të hiqet. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në vijim të sa shprehu kolegu Çakaj, siç dëgjuat është një bashkëpropozim, i cili natyrisht ka ardhur jo vetëm duke u bazuar në përcaktimet e ndryshimeve që ka pësuar Kodi, por dhe në autorizimin që ai na ka dhënë si KQZ, për të krijuar fillimisht këtë platformë. Lind pyetja, si krijohet platforma? Platforma krijohet nga rregulla parësore, parime, karakteristika... kjo nuk është një platformë, një tablo narrative, apo një tekst i cili fillimisht kërkonte disa parime të tekst shkrimit, apo të..., në rastet e teksteve ligjore, parimet juridike të së drejtës, por kjo është një platformë digjitale. Pra, është një platformë elektronike e cila domosdoshmërisht kërkon parimet dhe karakteristikat teknike të përgjithshme. Asnjë nga ne nuk është IT, në profesion në dijeninë time, por jemi juristë dhe e dimë mjaft mirë që t'i japim garanci dhe integritet një platforme e cila do të kryejë një proces kaq të rëndësishëm, unë mendoj dhe ju ftoj kolegë që të votojmë ashtu sikundër kemi bërë me paisjet e tjera elektronike që kanë sjellë risi në këtë proces dhe janë bërë të besueshme për publikun, si PEI, ashtu dhe PEVN. Ne të gjithë së bashku kemi votuar specifikimet teknike të këtyre paisjeve, qofshin të karakterit të përgjithshëm, apo specifikime teknike të cilat ndoshta futeshin edhe në pjesën e mënyrës se si do të përdorohet dhe mënyrës se si do të observohet, apo do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

auditohet më pas. Këto janë ato mjetet me të cilat i japim garanci kësaj platforme dhe fillimisht do ta bëjnë të besueshme për publikun, por nga ana tjetër do të ketë edhe një Roadmap për të gjithë ata që do të marrin pjesë në dhënien, përcaktimin, apo certifikimin e këtij integriteti. Ndaj unë, po besoj dhe kolegu i qëndrojmë këtij propozimi dhe kërkojmë që të votohet mundësisht nga ju nën logjikën që sapo shprehëm. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Në fakt me sa po shoh kolegë, fjalia që është në tekstin që unë lexova, “Karakteristikat e përgjithshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithshme të përdorimit të tij përcaktohen me akte të KQZ-së”. Me sa shoh, kolegu Çaka e ka zgjeruar dhe më tej këtë. Pra, flet për ngritjen, përdorimin dhe auditimin me aktet e KQZ-së. Nëse mundesh koleg edhe njëherë, ta lexosh propozimin tënd? Pra, është më i zgjeruar se sa është aty.

Z. M. Çakaj: Dakord! Por ne ndahemi te fjala “teknike”. Në gjykimin tonë nuk ka rëndësi se kush e miraton këtë akt. Në gjykimin dhe vlerësimin tonë, e rëndësishme është që krijimi i kësaj platforme, administrimi, auditimi, përditësimi të bëhet mbi bazë katakteristikash teknike si dhe rregullash, apo parimesh të përgjithshme, të cilat do të miratohen nga KQZ-ja. Qoftë nga Rregullatori, qoftë nga Komisioneri. Pra, nuk kemi ndonjë propozim konkret që ta miratojë Komisioni Rregullator. Por e rëndësishme është të ketë një akt të miratuar, mbi bazën e të cilit do të krijohet, do të funksionojë. Kam një pyetje për administratën. A është krijuar sot platforma?

Znj. J. Josifi: Jo! Sigurisht që jo.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Nuk është krijuar. Ne jemi në start të krijimit të platformës dhe në gjykimin dhe vlerësimin tonë si propozues të Kreut II do të duhet që të normohet. Procesi i krijimit, i organizimit, funksionimit, rregullimit, administrimit të të dhënave, integritetit të platformës dhe sigurisht auditimit.

Znj. I. Nano: Koleg, pas diskutimeve e vlerëson...

Z. D. Çaka: Një ndryshim..., meqenëse kuptohet që është pjesa e karakteristikave, si e mendoni “KQZ të miratojë me akte parimet dhe karakteristikat teknike për krijimin...”

Z. M. Çakaj: Për krijimin, organizimin, funksionimin, rregullimin..., po dakord.


Z. D. Çaka: Pra, tek ai amendamenti që unë propozova pas termit “karakteristika” të themi karakteristika teknike për krijimin, administrimin, mbikqyrjen dhe auditimin...”. Pra për të gjithë procesin deri te auditimi.

Z. M. Çakaj: Po, po!

Z. D. Çaka: Të shtohet pas karakteristikave të përgjithshme teknike, sipas akomodimit që keni bërë dhe ju në draft dhe të hiqet fjalia e fundit.

Znj. H. Vukaj: Po, se kjo mund të zgjidhet me akt të Komisionerit, nuk është çështje e karakterit normativ.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. I. Nano: Atëherë, kemi lexuar Kreun II i cili është ripunuar me kërkesë të kolegëve. Kemi dhe propozimin e kolegut Çaka, ku fjalia e fundit dhe e parafundit e pikës 7 të Kreut II, kërkohet të zëvendësohet me një fjali që kolegu sapo e lexoi. Po e lexoj dhe unë edhe njëherë. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me akt/akte parimet dhe karakteristikat teknike për krijimin, funksionimin, administrimin, mbikqyrjen dhe auditimin e PER, sipas legjislacionit në fuqi”. Kalojmë në votimin e këtij propozimi së pari dhe pastaj të Kreut II? Në çdo rast, propozimet që janë bërë do t’ju jepen me shkrim për të zbardhur aktin.

Së pari, kemi propozimin e kolegut Çaka.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çaka?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, meqenëse nuk kishim diskutime të tjera për Kreun II, kalojmë në votimin në tërësi të Kreut II me gjithë ndryshimin që sapo u miratua.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kreu III. Rregulla të Posaçme.


III.1. Krijimi i llogarisë në PER

Për krijimin e llogarisë së zgjedhësit në PER zbatohen këto rregulla:

1. Zgjedhësi ngarkon në platformë:

Zonja Xhina kishit diçka? Atëherë sikurse ju thashë, një pjesë e propozimeve të Komisionerit në aktin e ardhur para dy ditëve, janë riformuluar. Psh në këtë rast kemi

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

ndarjen në dy nënkrerë, ju kishit diçka në këtë moment?! Ndjesë se nuk pyeta në momentin... do të duhet ta lexoj njëherë dhe pastaj në qoftë se keni propozime për...

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PSSH: Për procedurë, pyeta nëse është propozim?

Znj. I. Nano: Po! Atëherë po vijoj të lexoj.

Kreu III. Rregulla të Posaçme.

III.1. Krijimi i llogarisë në PER.

Për krijimin e llogarisë së zgjedhësit në PER zbatohen këto rregulla:

1. Zgjedhësi ngarkon në platformë:

- numrin e tij personal të identifikimit, datëlindjen dhe vendlindjen e tij;
- një pamje të fytyrës së tij nëpërmjet sistemit “user liveness check”;
- një numër telefoni mobile, dhe/ose,
- një adresë email;

2. KQZ verifikon përputhshmërinë e të dhënave identifikuese të zgjedhësit të ngarkuara sipas pikës 1, të Kreut III. 1 me ato përkatëse në RKGjC.


Pasi të mbarojmë leximin do të pyesim administratën për disa gjëra.

3. Nëse verifikimi i të dhënave të ngarkuara me ato të RKGjC përputhen, atëherë zgjedhësit i krijohet llogaria e tij personale në PER.

4. Nëse të dhënat nuk përputhen, zgjedhësit i refuzohet krijimi i llogarisë përkatëse. Zgjedhësit të cilit i është refuzuar hapja e llogarisë personale në PER ka të drejtë të rikërkojë pa kufizim për hapjen e saj deri në 63 ditë para datës së zgjedhjeve. Në lidhje me kërkesën për hapjen e llogarisë në PER zgjedhësit i dërgohet një mesazh në numrin e tij të telefonit, ose me email, ose direk nëpërmjet PER.

Atëhere kolegë, para se të kalojmë në shqyrtimin e kësaj pike, do t’i lutesha kolegëve të administratës të printojnë dhe një kopje tjetër për Sekretaren e Përgjithshme,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

drejtoreshën dhe për zonjën Xhina, pra tre kopje. Po e ndërpres dy minuta, jemi këtu në sallë.

Rifillon mbledhja

Ora, 17:47

Znj. I. Nano: Atëherë filluam me shqyrtimin e Kreut III i cili është riformuluar. Pra, unë kam lexuar propozimin e ardhur dhe kemi III 1 “Krijimi i llogarisë në PER”. Nëse kolegët kanë diçka për të shtuar, për të pyetur? Përfaqësues të partive politike nëse kanë diçka? Nga administrata u kërkua pak më herët fjala, zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Thjesht një sqarim teknik. Propozimi juaj për pikën 2 të këtij Kreu...

Znj. I. Nano: KQZ verifikon përputhshmërinë...

Znj. J. Josifi: .. e të dhënave identifikuese të zgjedhësit të ngarkuara sipas pikës 1, shkronjës “i”. Pra, vetëm pjesa e parë e pikës 1 mundet që të verifikohet në mënyrë automatike me ato përkatëse të tij në RKGjC, me të dhënat përkatëse të zgjedhësit në RKGjC, faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord! Pra, pika 1, shkronjës “i”, të Kreut III 1.

Znj. J. Josifi: Ose për të qenë më të qartë ndoshta, të riemërtohen ato në “a, b, c, d”, në këtë rast do të ishte pika “a”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. I. Nano: Atëherë, kolegë për hir të shkrimit këto pikat “i”, “ii”, “iii” duhen zëvendësuar me “a”, “b”, “c” dhe e kemi më mirë referencën se kështu do vazhdojmë dhe më poshtë. Pra, thjesht teknikisht do të bëhen “a”, “b”, “c” dhe këtu nuk ka nevojë për votim. Të bëhet referenca e saktë. Pika 1, shkronja “a” e Kreut III 1. Pra, le të themi ky është teksti. Kemi diçka për këtë tekst?

Z. M. Çakaj: Jo për tekstin s’kemi, por kemi pyetje.


Znj. I. Nano: Pyetje, patjetër!

Z. M. Çakaj: Duke qenë se unë e kërkoja dhe në mbledhjen e kaluar. Pra, nuk e kemi një paraqitje grafike të këtij procesi dhe do të sugjeroja, administratës që në aktet e tjera, ta kishim një paraqitje, një demostrim grafik për ta bërë sa më të thjeshtë procesin, qoftë edhe në fazën e paraqitjes të një projektvendimi, në mënyrë që ta kuptojmë ne që do ta shqyrtojmë dhe miratojmë këtë akt dhe më pas të jetë sa më i thjeshtë dhe për zgjedhësit nga jashtë. Në mënyrë të përmbledhur, a mundet të na shpjegoni gjithë këtë procesin e krijimit të llogarisë në PER? Pavarësisht se është shkruar këtu, të na e shpjegoni në mënyrë sa më të përmbledhur dhe sa më të thjeshtë. Çfarë duhet të bëjë zgjedhësi që ka përpara ose një celular, një telefon mobile, ose një kompjuter? Çfarë duhet të bëjë zgjedhësi? Pra, për ta bërë sa më të thjeshtë procesin, e para dhe e dyta, çfarë është ky sistemi “user liveness check”?

Znj. I. Nano: Zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Po e nis nga pyetja e dytë, meqenëse është vetëm sqarim, me përgjigjen e pyetjes së dytë. Ajo që ne kemi pasur parasysh kur kemi kërkuar këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

gjë është që realisht të sigurohemi që përpara kameras së telefonit celular, apo të kompjuterit, apo të laptopit, apo të tabletit. Pra, të paisjes nga ku zgjedhësi do të krijojë llogarinë e do të çojë kërkesën e tij për regjistrim, të shfaqet vërtet ai, i gjallë në mish e në kocka, le ta themi kështu dhe jo një foto e tij që do të mund ta dispononte gjithkush tjetër. Ky sistem ...

Znj. I. Nano: Ta plotësoj me një pyetje unë, pyetjen e kolegut?! Besoj të gjithë kemi dalë jashtë Shqipërisë dhe jemi kthyer nga aeroporti i Tiranës. Është ai procesi që ndodh kur hyjmë në Republikën e Shqipërisë, pra që pasi skanojmë pasaportën hapet porta e parë dhe më tej jemi në bashkëveprim. Pra, kjo është që ta kuptojmë më mirë?

Z. M. Çakaj: Shumë dakord, po atje tek ajo shfaqen shqip “Njohje biometrike e fytyrës”.

Znj. J. Josifi: Është më shumë se sa kaq, është më shumë se sa njohje biometrike...

Z. M. Çakaj: Shumë dakord! A ka një term në gjuhën shqipe të këtij procesi?

Znj. J. Josifi: Jo, teknikisht jo! Është një term që ne e përkthejmë, por ky është termi teknik. Ne do të bëjmë një përkthim, por ju lutem, mos e merrni si një përkthim të certifikuar.

Z. M. Çakaj: Jo, nuk ka problem, përshtatje, s’ka problem, për ta bërë sa më të thjeshtë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. I. Nano: Më fal zonja Vukaj! Për të mos krijuar konfuzion, le ta lemë dhe këtë në anglisht se kjo e.... dhe e vemë në kllapa, ose e ..

Z. M. Çakaj: Ose ekzaktësisht, për teknikë legislative do të duhet formulimi në shqip dhe në kllapa, ekzaktësisht termi teknik në anglisht. Nuk është e thënë përkthimi fjalë për fjalë.


Znj. H. Vukaj: Në qoftë se ky termi është marrë nga ndonjë rregullore, për hir të atyre që do të auditojnë procesin, do t'i kenë këto akte përpara, si mjete zbatimi, komunikimi me të tjerët që do t'i zbatojnë. Përdorni atë për referencë dhe ndërkohë përpikuni të gjeni shprehjen e duhur shqipe, e para. E dyta, këtu thuhet: “Zgjedhësi ngarkon në platformë, një pamje të fytyrës së tij nëpërmjet sistemit”. Pra, ky është sistem që e përmban automatikisht çdo paisje.., pra platforma?

Znj. J. Josifi: Kjo është një karakteristikë teknike e platformës, po! Zgjedhësi nuk ngarkon në platformë një pamje të fytyrës. Zgjedhësi shfaqet para kamerës së paisjes së tij. Ky sistemi, platforma PER ka këtë aftësinë teknike për të kuptuar nëse ajo çfarë i është shfaqur përpara kameras, është foto, apo është një person i gjallë përpara. Kjo është një karakteristikë teknike, aftësi.

Znj. H. Vukaj: Në pritshmërinë tonë dhe të akteve të tjera, kjo nënkupton që kjo do të jetë një nga karakteristikat që do të përmbajë platforma PER për t'i adresuar krijuesit të saj, apo autoritetit që e merr përsipër vënien në zbatim.

Z. M. Çakaj: Besoj në karakteristikat teknike, patjetër që do të jetë edhe i materializuar fakti, apo përkufizim, ose karakteristika që ky sistem i njohjes së

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

fytyrës live të zgjedhësit, do të duhet të jetë i përshtatshëm ose kompatibël me gjithë telefonat, versionet e kompjuterave.., besoj se do të jetë i përshtatshëm, që të mos ketë një mospërputhshmëri të llojit të telefonave, të llojit të paisjes që përdor zgjedhësi në këtë sistem, se është e nevojshme të jetë sa më i aksesueshëm, besoj?!

Znj. J. Josifi: Po! Në aneksin që erdhi në aktin e ripropozuar nga Komisioneri ditën e hënë, të karakteristikave teknike të platformës elektronike, pjesa e tretë, janë përmendur të gjitha këto. Pra, psh thuhet, po lexoj vetëm pikën që lidhet me këtë moment “të kryejë kontrollin e “liveness”..” në thonjza “... dhe të krahasojë pamjen e marrë me fotografinë e profilit të siguruar nga dokumenti i identifikimit fizik”. Pra, të bëjë krahasimin midis të dyjave. “Të lexojë nxjerrjen e fotografive nga dokumentet e identifikimit në letër..”, pra dokumenti i identifikimit, pasaporta, apo një letër njoftimi, “.. dhe krahasimin me selfin e shtetasit për të verifikuar identitetin”. Praktikisht ishte transpozim i rekomandimit që na erdhi se si do të duhej të verifikohesh realisht identiteti i zgjedhësit.., që na erdhi në seancën e parë. Ne e përkthyem kështu, po themi në draftin e ri, sjellë nga Komisioneri para jush.

Z. M. Çakaj: Në përgjigje-pyet, nuk do të ketë kufizim?


Znj. J. Josifi: Jo!

Z. M. Çakaj: Mund ta realizojë me paisje të vjetra, të reja, të markave të ndryshme, versioni telefon, apo versioni desktop, s’do të ketë?

Znj. J. Josifi: Po, sepse paisja që përdor “enduser”, ose përdoruesi fundor do të ketë të instaluar aplikacionin që është hapi i parë...

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: I cili do ta ketë të inkorporuar edhe këtë sistem?

Znj. J. Josifi: Po!

Z. M. Çakaj: Qartë!

Znj. H. Vukaj: Edhe një pyetje teknike të lutem! Në vazhden e transparencës për publikun, apo teknicienë të tjerë të interesuar në këtë moment, unë kam pyetjen: PER kjo platformë, ku e gjen bazën e të dhënës për “face recognition”, ose njohjen e fytyrës, ose krahasimin real të fytyrës me atë të dokumentuar, sepse e dimë që paisjet, platformat do të jetë një platformë elektronike dixhitale, e ngritur mbi bazë të programimit, algoritmeve etj., etj.. Pra, kjo paisja do të ketë të inkorporuar një të dhënë të marrë nga database biometrik që Ministria e Brendshme dhe autoriteti respektiv në varësi të ministrisë ka dhe disponon sot?

Znj. J. Josifi: Ashtu siç ishte propozuar në projektvendimin e Komisionerit, jo! Sistemi nuk do të ketë një kopje të databases së gjendjes civile e cila përmban edhe fotot e dokumentave të identifikimit, por krahasimin PER-i do ta bëjë me vetë dokumentin e identifikimit që përdor zgjedhësi kur ka hapur llogarinë. Pra, me dokumentin që ai ka në dorë, qoftë ajo pasaportë, qoftë letërnjoftim.

Znj. H. Vukaj: Nga ana teknike konsiderohet që mund të ketë marzhe gabimi? Ose materialiteti i riskut sa është? Keni bërë një kualifikim deri tani, ose një nxjerrje të dhëne, ose një vlerësim nga teknicienë, apo programues?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. J. Josifi: Është një teknologji “cross check” e të dhënave biometrike, që është e mirënjohur në botë. Përdoret në fusha të ndryshme, jo thjesht atë të identitetit. E përdorin bankat jashtë, ashtu siç e përdorin edhe operatorët e mëdhenj të shërbimeve celulare. Ju kujtoj këto “face recognition” të apple, samsung-ut dhe produkteve të tjera. Sigurisht që ka një përqindje të caktuar, e cila është minimale, Është një teknologji e mirënjohur tashmë nuk është një risi kjo që kemi propozuar në kuptimin e kontekstit në vend. Ju lutem, thjesht ti rikthehem përgjigjes për pyetjen e parë? Ju përgjigja thjesht vetëm pyetjes së dytë.

Znj. I. Nano: Po për pyetjen e zotit Çakaj.

Znj. J. Josifi: Ne mund të bëjmë një paraqitje grafike të hapave që do të ndjekë zgjedhësi, menjëherë edhe në seancën e rradhës. Megjithatë në aneksin që kishim propozuar meqë na u kërkuan karakteristika të përgjithshme teknike, ne kemi vënë hapat e këtij procesi. Hapat që do të duhet të kryejë zgjedhësi nga ana e tij dhe ato që bën KQZ-ja, le të themi, në back office të sistemit për të shqyrtuar kërkesat. Unë mund ti kaloj një nga një, është faqja e parë, pjesa që i takon zgjedhësit, e aneksit. Hapi parë është ai do të shkarkojë platformën, të cilën do ta gjejë falas. Pra, kush do ta bëjë këtë proces nga telefoni i tij celular, qoftë ai android, apo iOS do të shkojë në App Store, në këtë rast dhe do të shkarkojë platformën. Do të kërkojë PER (Platforma Elektronike e Regjistrimit), do të shkarkojë platformën siç bëjmë me çdo aplikacion tjetër. Nëse do të dojë ta bëjë këtë gjë nga ndonjë paisje desktop, laptop etj., pra jo mobile, do të duhet të klikojë në URL-në që do të jetë e disponueshme për ta shkarkuar këtë platformë në website, në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Në këtë moment e shkarkoi këtë platformë. Ai do të skanojë, do të nxjerrë përpara kameras së paisjes dokumentin e tij të identifikimit. Sistemi automatikisht do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*


lexojë të dhënat që ka dokumenti i identifikimit. Po marr rastin e letërnjoftimit, do të lexojë automatikisht. Pra, pa i shtypur dikush si fusha këto, numrin personal, emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe do të skanojë foton e dokumentit të identifikimit. Pra, do ta lexojë vetë. Hapi i tretë është: zgjedhësi do të hapë kamerën frontale të paisjes. Në rastin që është një celular është e thjeshtë, po themi do të bëjë një selfi, thënë kështu thjeshtë, ose kamerën e laptopit, apo atë që ka përpara kompjuterit për të bërë këtë procesin e njohjes së pamjes së fytyrës që e thamë, face recognition. Për të shmangur mashtrimet, ose gabimet, kemi thënë ne, do të sigurohet PER se fytyra që është shfaqur është vetë zgjedhësi dhe jo një fotografi e tij, pra do të kontrollojë nëse është një person i gjallë përpara kamerës dhe nëse kjo pamje përputhet me atë foton që sapo skanoi në hapin paraardhës nga ID, nga letërnjoftimi. Zgjedhësi duhet të përcaktojë nëse kodin 6 shifror që është faktori i tretë, dëshiron ta marrë me email, apo me sms, sepse mund të ketë dikush vetëm email, dikush vetëm numër celulari, ose të dyja. Menjëherë në shenjë verifikimi platforma, sapo ai të fusë psh numrin e tij celular, do t'ia çojë kodin e parë me sms...

Z. M. Çakaj: Një sekondë, të lutem! Pra, ju po thoni që mjafton, ose celular, ose email...

Znj. I. Nano: Më falni, jemi live, apo jo, teknika? Dakord! Doja të dija, se të gjitha këto detaje të kalojnë për publikun.

Z. M. Çakaj: Pra, ju po sqaroni të gjithë hapat teknikë dhe nga sa ju po sqaroni, rezulton se është e nevojshme ose një numër telefoni, ku do t'i vijë kodi 6 shifror, ose një adresë emaili, sepse në Kreun III, pika "iii", këtu parashikohet në mënyrë kumulative që do të duhet edhe një numër telefoni;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. I. Nano: “.. dhe ose..” e lexuam. Nëse i ka të dyja dakord, por mundet edhe njëra.

Z. M. Çakaj: Nëse është njëra, ose tjetra është në rregull.

Znj. J. Josifi: Teknikisht ne mundet...

Znj. H. Vukaj: Më herët, edhe zoti Nuri në mbledhjet pararendëse, ngriti shqetësimin dhe kjo është absolutisht e vërtetë, që fasha moshore e caktuar nuk kanë dhe nuk disponojnë email, sepse nuk është detyrim. Mjafton ai numri i telefonit të jetë parësor për dergimin e të dhënave.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj, në fakt edhe unë bashkohem me mendimin tuaj që sapo ne ta miratojmë këtë akt dhe KQZ-ja të fillojë punën dhe kur them punën jo vetëm me miratim aktesh, por dhe duke marrë masa teknike-organizative për krijimin e platformës, pa dyshim që një informacion i tillë që po na përcillet nga zonja Josifi në këtë moment, do të duhet të shoqërohet edhe me paraqitje grafike, sikundër u tha që do të jetë pjesë e fushatave të ndërgjegjësimit dhe të informimit të zgjedhësve. Nëse nuk kemi pyetje të tjera, të kalojmë në votimin e Kreut III 1 “Krijimi i llogarisë në PER”?

Kush është dakord kolegë?


Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

III. 2 Rregjistrimi në listën e zgjedhësve


*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

1. Hyrja e zgjedhësit në llogarinë e tij në PER bëhet nëpërmjet përdorimit të 3 (tre) faktorë autentifikimi.
2. Njëri prej faktorëve autentifikues duhet të jetë biometrik, me njohje të fytyrës (face recognition) faktori tjetër është një kod unik i përkohshëm 6 shifror që i dërgohet zgjedhësit në numrin e tij të telefonit mobile dhe/ose email, si dhe faktori i tretë është Numri Personal i Identifikimi (NID) i zgjedhësit dhe fjalëkalimi.
3. Zgjedhësi paraqet kërkesë për tu regjistruar në listën e zgjedhësve nga jashtë, nëpërmjet llogarisë së tij të krijuar në PER, duke ndjekur këto hapa:
 - a) Skanon përmes PER një dokument identifikimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, pasaportë për jashtë shtetit, ose letërnjoftim. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsye të ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. Në çdo rast PER i krijon mundësi zgjedhësit që të ngarkojë të skanuar dokumentin përkatës të identifikimit. Këtu do të kem unë një pyetje më vonë.
 - b) Ngarkon në PER të paktën një dokument që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e dokumenteve të tillë miratohet me akt të veçantë të Komisionit Rregullator.
 - c) Adresën e banimit e cila duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna: shtetin, kodin postar, qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës, si dhe elementë të tjera të adresës, nëse ka.
4. Kërkesa për regjistrim është individuale dhe PER nuk lejon që ajo të paraqitet në emër të një personi tjetër dhe/ose nga një llogari e një personi tjetër.
5. Me paraqitjen e kërkesës sipas pikës 3, të Kreut III/2, zgjedhësi merr një njoftim automatik nga PER se kërkesa e tij do të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së saj në platformë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

6. PER i ofron mundësinë zgjedhësit që ka paraqitur kërkesën për të ndjekur/gjurmuar statusin e shqyrtimit të saj.

Atëherë, për Kreun III 2, partitë politike kanë diçka? Unë një pyetje kam, po nëse ka propozime nga ju? Jo! Te pika 3, shkronja “a”, fjalia e fundit “Në çdo rast PER i krijon mundësi zgjedhësit që të ngarkojë të skanuar dokumentin përkatës të identifikimit”. Unë nuk arrij ta kuptoj mirë, mund të jem unë e paqartë, sepse në fillim thotë “skanon përmes PER-it”. Është në rregull? Pra, e skanon përmes PER-it dhe e ngarkon. Si? Thjesht teknikisht? Le të më thotë kolegja?


Z. M. Çakaj: Ose të na sqarojë, nëse e kemi kuptuar drejt! Atëherë nga demonstrimi që ju sapo parashtruat hap pas hapi do të rezultojë që zgjedhësi që kërkon..., shtetasi shqiptar që banon jashtë shtetit... Jeton, banon, ndodhet jashtë shtetit dhe shpreh vullnetin për t’u regjistruar nga jashtë shtetit ka në dorë një dokument identifikimi dhe aplikacioni i mundëson në hapin konkret që ai ta skanojë atë, ta nxjerrë atë përballë ose paisjes celulare, ose laptopit, desktopit, gjithshka dhe e njih automatikisht. E skanon automatikisht sistemi.

Znj. J. Josifi: Po!

Z. M. Çakaj: Nëse nuk ndodh, ose për një..., mund të jetë i dëmtuar dokumenti i identifikimit dhe mund të ndodhë, jo në pak raste që nuk e njih. Atëherë, vetëm nëpërmjet NID-it është i detyruar shtetasi shqiptar të bëjë regjistrimin manual?

Znj. J. Josifi: Atëherë, fjalia e fundit, që zonja Nano përmendi, nuk ishte propozim i yni, por bën sens, logjikë dhe teknikë...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. I. Nano: Mos duhet, “të ngarkojë dokumentin e skanuar”, se skanimi është hapi i parë.

Znj. J. Josifi: Skanimi është hapi i parë dhe është çdo herë. Pra, sa herë ai do të duhet të logohet në PER, se mund të mos e mbyllë kërkesën për regjistrim që herën e parë, se kuptoi se i mungon diçka, do të marrë një dokument

Znj. H. Vukaj: Bën skanimin për të identifikuar dhe verifikuar që personi është gjallë. Pra, është i gjallë, nuk mund të manipulohet me një fytyrë tjetër, përveçse atij.

Z. M. Çakaj: Ideja është këtu. Ky është procesi i hyrjes në aplikacion,

Znj. J. Josifi: Po! Që ndodh çdo herë njësoj.


Z. M. Çakaj: Çdo herë që ti hyn do të duhet me këto faktorë autentifikimi, ose me këto elementë do të duhet që të hysh në llogarinë tënde. Nuk mjafton vetëm hapja, që të kesh një fjalkalim, por do të duhet..., këto janë?

Znj. J. Josifi: Çdo herë!

Z. M. Çakaj: Qartë!

Znj. I. Nano: Edhe zonja Vukaj, në cilësinë e propozueses, bashkë me zotin Çakaj në fakt, të kësaj fjalie thotë “ndoshta”? Ndaj po e shtrojmë pyetjen se ndoshta ka diçka që nuk shkon në ndërtimin e fjalisë, por në raport me mundësitë teknike. Pra,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

“Në çdo rast PER i krijon mundësi zgjedhësit të ngarkojë të skanuar dokumentin..”,
apo të ngarkojë dokumentin?

Znj. J. Josifi: Mund të ndodhin të dyja. Për efekt të...

Znj. I. Nano: Duket sikur ke një dokument të skanuar diku dhe e ngarkon.

Znj. J. Josifi: Jo, jo. Atëherë, qëllimi ka qenë ky. Çdo herë që zgjedhësi hyn, ai
nxjerr përpara kamerës dokumentin e identifikimit...

Znj. I. Nano: Pra, i krijon mundësinë zgjedhësit që të skanojë.., i krijon mundësinë
në çdo rast... PER i krijon mundësinë zgjedhësit të skanojë dokumentin përkatës, se
ngarkimin dhe mund ta ketë bërë më përpara, ose të skanojë dhe ngarkojë. Janë dy
procese të ndryshme, apo bëhen automatikisht?


Znj. J. Josifi: Janë dy procese të ndryshme. Në momentin fillestar që nxjerrim
dokumentin e identifikimit para kameras, sistemi kap nga ky dokument identifikimi
të gjitha të dhënat që i duhen. Ky është një skanim onetime, si të thuash. Skanim
quhet edhe nëse dalim me fytyrë para kameras, edhe nëse nxjerrim një të dhënë tjetër
përpara kameras.

Z. M. Çakaj: Më fal, mund ta bëjmë më të thjeshtë procesin dhe më të kuptueshëm.
A mund të kemi një kartë identiteti këtu? Ta bëjmë më të thjeshtë, të bëjmë një
paraqitje!?

Znj. I. Nano: Po zonja Josifi, kemi një kartë identiteti. Nëse mundeni!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. J. Josifi: Pra, meqë platforma e skanon dhe e lexon automatikisht të dhënat, ne nuk kishim nevojë që zgjedhësi të ngarkonte ai, pra të bënte upload. Ky është koncepti i ngarkimit teknik të një file.

Z. M. Çakaj: Pra, zgjedhësi do të duhet ta paraqesë nga pamja ballore këtë dokument identifikimi. Në rastin konkret nuk është pasaportë, por është kartë identiteti. Pra, i lexon aplikacioni automatikisht të gjithë të dhënat?

Znj. J. Josifi: Po, i lexon automatikisht.

Z. M. Çakaj: Nuk i merr të dhënat psh nga chip-i që është pas, por i lexon nga pamja ballore?


Znj. J. Josifi: Pamja do të jetë kështu, pra zgjedhësi do të duhet ta nxjerrë kështu dokumentin e identifikimit.

Z. M. Çakaj: Nga ana e përparme e dokumentit të identifikimit që janë të gjitha.

Znj. J. Josifi: Nga ana e përparme e dokumentit, pra, i lexon të gjitha të dhënat. Ashtu si ne e kishim shprehur nuk kishte nevojë që zgjedhësi të ngarkojë, të bëjë upload një.. pra, të ketë shkuar në një paisje, në një skaner, të ketë skanuar dokumentin e identifikimit dhe t'i bëjë upload këtij file në pdf, apo në foto, sepse do të bëhet menjëherë.

Znj. I. Nano: Pra, kjo fjalia e fundit, qëndron kështu, apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. J. Josifi: Megjithatë fjalia e fundit qëndron, sepse nuk e përjashton njëra gjë tjetrën. Le të mbajë platforma dhe një kopje të dokumentit, nuk ka asnjë problem. Platforma në këtë rast, përveçse e skanoi në momentin fillestar, do t'i bëjë një foto gjithashtu dhe e ruan...

Z. M. Çakaj: Dhe e uploadon herë pas here?

Znj. J. Josifi: Po! Zgjedhësi edhe mund ta përditësojë pastaj këtë file.

Z. M. Çakaj: Qartë, për thjeshtësi e kanë ose në celular, ose në desktop, kompjuter, laptop dhe e ngarkon në çdo rast. Do ta ketë këtë mundësi?

Znj. J. Josifi: Po!

Znj. I. Nano: Atëherë, unë si pyetje këtë kisha. Nuk e di nëse...

Znj. J. Josifi: Në këtë rast rolin e skanerit e luan kamera e telefonit, edhe këtë letrën tani, nëse ne hapim kamerën e thjeshtë të telefonit e inkuadron...


Znj. H. Vukaj: E skanon përmes kameras duhet aty.

Z. M. Çakaj: Jo, jo, e skanon, është në rregull, është në rregull.

Znj. J. Josifi: Përmes PER, sepse nëse nuk do të kishim këtë aplikacion...

Znj. H. Vukaj: Kush ia jep mundësinë që ta marrë PER-i pra, ia jep kamera.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. J. Josifi: Sepse ai ka hapur PER-in, ai është në PER, ai nuk është në kamerën e thjeshtë të celularit, më kupton? Po ju ilustruj diçka në aplikacionin mobile të KQZ-së. Aplikacioni mobile i KQZ-së psh ka 5 butona. Në fund ka një buton që thotë “QR Scan” në këtë rast skanon QR, por mund të skanojë foto, dokument tekst dhe ja si është pamja e kamerës. Pra, unë kam hyrë në aplikacionin e KQZ-së dhe po skanoj diçka.

Znj. H. Vukaj: Ti sapo e bërë përmes kamerës.

Znj. J. Josifi: Po pra, po në aplikacion. E kuptoj se çfarë doni të thoni, por na humbet kuptimi teknik. Kamera është paisja që e bën, por jemi në këtë platformë.

Znj. I. Nano: Ky lloj skanimi bëhet vetëm kur ke hyrë në profikin tënd?


Znj. J. Josifi: Po, ke hapur PER.

Znj. I. Nano: Dakord! Unë pyetje këtë kisha, keni ndonjë propozim?

Z. M. Çakaj: Po! atëherë në Kreun III 2, në pikën 3, shkronja “b” unë do të doja të plotësohej pas fjalisë “Lista e dokumentave të tillë miratohet me akt të veçantë të Komisionit Rregullator”, do të bëja propozimin konkret që të vazhdonte fjalia dhe të riformulohet si më poshtë: “Lista e dokumentave të tillë..,

Znj. I. Nano: ... e këtyre dokumentave, më mirë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*


Z. M. Çakaj: “Lista e këtyre dokumentave..” pra, bëhet fjalë për dokumenta të cilat vërtetojnë qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të zgjedhësit që po kryen procesin e regjistrimit dhe po shfaq vullnetin për t’u regjistruar për të votuar nga jashtë. “Lista e këtyre dokumentave, miratohet me akt të veçantë të Komisionit Rregullator, i cili vendos edhe kufizim të numrit të zgjedhësve të regjistruar në një adresë, si dhe përjashtimet përkatëse”. Në rastin konkret ky është një propozim për një dispozitë tranzitore dhe rregullimin konkret do ta bëjmë në aktin që Komisioneri do të propozojë për listën e detajuar të dokumentave që provojnë qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të zgjedhësit që kërkon të ushtrojë këtë vullnet për të votuar nga jashtë. E cila mund të jetë, mund të përfshijë shumë dokumenta, por do të duhet të bëjmë një kufizim për të përjashtuar kërkesat e pajustificuara, ose kërkesa të cilat nuk përmbushin kriteret të cilat ne do të miratojmë me akte rregullatore.

Znj. I. Nano: Pra, dhe njëherë zoti Çakaj, “Lista e këtyrë dokumentave, miratohet me akt të veçantë të Komisionit Rregullator, i cili vendos edhe kufizim të numrit të zgjedhësve të regjistruar në një adresë, si dhe përjashtimet përkatëse”. Pra, duke i dhënë ne autorizimin vetes për ta bërë në aktin e rradhës? Po! Propozime të tjera për Kreun III, 2? Zonja Xhina!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PSSH: Për teknikë legislative më tepër. Në pikën “c” fillon menjëherë fjalia “adresën e banimit”, por nuk na shpjegon detyrën që duhet të bëjë zgjedhësi. Pra, jemi tek “a” skanon, “b” ngarkon, çfarë bën te “c”? Ngarkon sërish?

Z. D. Çaka: Shton, ose...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PSSH: Atë të na e shpjegojë administrata, por që duhet plotësuar.

Znj. I. Nano: Ngarkon, në fakt e kemi pas në aktin e propozuar. Pra, ngarkon adresën e banimit, ngarkon të dhënat e adresës së banimit...

Znj. J. Josifi: Ngarkon në PER, ka qenë, të dhënat e mëposhtëme:

Adresën personale të postës elektronike email dhe/ose numrin e celularit personal. Pika “b” ishte “adresën e banimit e cila duhet të përmbajë këto të dhëna..”.

Znj. I. Nano: Këtë akt gjeta, prandaj “ngarkon adresën e banimit”. Nuk është një dokument adresa e banimit që të ngarkohet ë? Të dhënat e adresës së banimit si më poshtë: shtetin, kodin, qytetin, emërtimin e rrugës, numrin e banesës, si dhe elemente të tjera të adresës nëse ka, ose që përfshin.


Znj. J. Josifi: Nuk është dokumenti, thjesht një folje, “jep të dhënat”, “i shkruan ato”, ky është qëllimi. Plotëson disa fusha në platformë është ideja. E njejta gjë vlen në të dy rastet edhe posta elektronike email, numër celulari edhe adresa e banimit, pra plotëson.

Znj. I. Nano: Dakord! Për teknikë nuk do ta hedhim në votim këtë gjë. Plotëson adresën e banimit, ngarkon e kishim tek akti i parë.

Znj. H. Vukaj: Plotëson përshtatet më mirë.

Znj. I. Nano: Për ju teknikisht, fjala më e përshtatshme?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Fjala më e përshtatshme është regjistron.

Znj. I. Nano: Për mua “Regjistron adresën e banimit e cila duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna”.

Znj. J. Josifi: Ai nuk e regjistron, ai po bën një kërkesë për regjistrim dhe ai po jep disa të dhëna.

Z. M. Çakaj: Në këtë hap konkret, regjistron, shënon.

Znj. J. Josifi: Jep të dhënat mund të shkonte...


Znj. I. Nano: Shënon adresën e banimit e cila duhet të përmbajë këto të dhëna... jemi dakord me një konsensus pa e votuar, sepse për të votuar kemi propozimin e zotit Çakaj.

Znj. J. Josifi: Më e sakta do të ishte plotëson. Pra, ai vetë shkruan të dhënat e tij.

Znj. I. Nano: Shënon është më mirë, plotëson është sikur ke disa rubrika për t'i plotësuar atje.

Znj. J. Josifi: Shënon në kuptimin e sistemeve duket sikur vëmë një koment aty i cili nuk ka një vlerë aktive, po themi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Kemi për të votuar propozimin e zotit Çakaj, për riformulimin e fjalisë së dytë të shkronjës “b”... votojmë propozimin e zotit Çakaj për të riformuluar fjalinë e dytë të shkronjës “b”, të pikës 3, të Kreut III 2, të këtij projektvendimi.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj, sikundër u lexua nga ana e tij dhe nga ana ime? Kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë për votimin Kreun III 2. Regjistrimin në listën e zgjedhësve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kreu IV. Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit


1. KQZ vendos për kërkesën për regjistrim jo më vonë se 5 ditë nga data e depozitimit të saj në PER.

2. Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim bëhet si vijon:

a) PER përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të zgjedhësit të cilat u përftuan sipas pikës 1, shkronja “a”, të kreut III 1, të këtij vendimi.

b) PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit, siç parashikohet në pikën 1, shkronja “b” të Kreut III 1 të këtij vendimi, me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit sipas pikës 3, shkronja “a” të Kreut III 2, të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

c) Verifikohet nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e deklaruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.

3. Nëse kërkesa për regjistrim e zgjedhësit, plotëson sa përcaktohet në pikën 2 të këtij Kreu, atëherë zgjedhësi regjistrohet në listën e zgjedhësve të votuesve nga jashtë vendit. Nëse të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij Kreu nuk plotësohet, kërkesa për regjistrim e zgjedhësit nuk pranohet. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përmbajë edhe shkaqet e mospranimin.

4. Vendimi mbi shqyrtimin e kërkesës i njoftohet zgjedhësit në llogarinë e tij në PER dhe/ose në adresën e postës elektronike (email) të deklaruar nga ai. Llogaria e tij mbetet aktive dhe aksesueshme në çdo kohë me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar.

5. Në rastin kur pranohet kërkesa e zgjedhësit për regjistrim, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) vijon me regjistrimin në RKGjC të adresës së zgjedhësit përkatës që voton jashtë vendit në një rubrikë të veçantë.


6. Zgjedhësi të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim mund ta ripërsërisë kërkesën pa asnjë kufizim në herë deri në orën 24:00 të datës së fundit kur lejohet paraqitja e kërkesave për regjistrim në PER.

7. Në listën përfundimtare të zgjedhësve do të përfshihen ata zgjedhës të cilëve u është pranuar kërkesa për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

8. Në rast të vështirësive për të realizuar regjistrimin sipas hapave të mësipërm, zgjedhësi mund të ruajë draft kërkesën e tij në PER dhe të kontaktojë për ndihmë teknike lidhur me procesin e regjistrimit, shërbimin e ndihmës që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos në dispozicion të zgjedhësve nga jashtë vendit përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit.

Kemi ndonjë pyetje për këtë pikë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Po kisha unë një pyetje. Siç ju vijuat pak më parë të hapave konkretë, do të doja një sqarim mundësisht shterues, lidhur me procesin e verifikimit të përputhshmërisë, pra në pikën 2, shkronja “b”, parashikohet... Propozimi ynë do të jetë PER, ka qenë dhe në propozimet e mëparshme dhe në propozimin e Komisionerit “PER, automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit siç parashikohet në pikën 1, shkronja “b” të Kreut III 1 të këtij vendimi, të cilin sapo e miratuam, me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit sipas pikës 3, shkronja “a” të këtij vendimi”. Pra, të dhënat që ngarkon zgjedhësi ku përfshihet përveç të dhënave është edhe foto, që përmban dokumenti i identifikimit. Do të kryhet një proces përputhshmërie. A mundet ky aplikacion, platforma ta kryejë këtë gjë? Dhe me çfarë saktësie, në eksplorimin që keni bërë ju, deri tani.

Znj. J. Josifi: Patjetër që mund ta kryejë, është një nga karakteristikat, do të duhet të jetë për sa kohë vendoset ...

Z. M. Çakaj: Teknike!


Znj. J. Josifi: Po teknike të sistemit. Është ajo që ju thashë pak më parë në përgjigje të pyetjes. Ka një marzh gabimi në përqindje secili nga sistemet...

Z. M. Çakaj: Dhe cili është?

Znj. J. Josifi: Do të duhet ta vemë këtë si kërkesë teknike në projektimin e sistemit. Pra, duhet të kërkojmë një minimum dhe një maksimum.

Z. M. Çakaj: Nuk e kemi paraprakisht një marzh gabimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Znj. J. Josifi: Jo! Por të gjitha sistemet e kanë. Kush aplikon këtë teknologji të check të të dhënave biometrike e bën...

Z. M. Çakaj: Të të marr një shembull konkret...

Znj. J. Josifi: Po!


Znj. H. Vukaj: Jo, pak më herët zonja Josifi tha që “marzhi i gabimit është pothuajse i papërfillshëm për shkak se aplikacionet e deritanishme kanë qenë shumë të suksesshme. Por, për hir të garancisë që duhet të japim të gjithë shtetasve shqiptarë, ne na duhet ta dimë këtë marzh gabimi, me qëllim që të vlerësojmë pastaj situatën se sa ndikim ka kjo, apo sa impakton.

Z. M. Çakaj: Nëse nuk e keni të dhënë tani edhe në mbledhjet e mëpasme na e vini në dispozicion.

Znj. H. Vukaj: Në mbledhjet e tjera bazohuni në një manual tuajin teknik dhe të kemi një referencë të besueshme.

Z. M. Çakaj: Kam një pyetje konkrete. Përveç rasteve kur dokumenti mund të jetë i dëmtuar pjesërisht, ose totalisht në anën ku ndodhet foto e dokumentit të identifikimit të shtetasit që kërkon regjistrimin, përveç këtij rasti. Ka raste kur foto e dokumentit të identifikimit është bërë, se vlefshmëria, e dimë që e kemi dhjetë vjeçare të dokumentit. Dokumenti i identifikimit është i para nëntë viteve dhe sot do të kryhet përputhshmëria midis këtij procesi. Ekziston., teorikisht patjetër që ekziston, por ekziston mundësia që të mos e njohë foton e dokumentit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

identifikimit? Edhe për hir të ndryshimeve biologjike që mund të pësojë fytyra e një njeriu.

Znj. J. Josifi: Algoritmi i njohjes së face recognition do të duhet të kuptojë të dhënat biologjike, nuk do të merret me krahasimin e ngjyrës së flokëve apo më pak, apo më shumë flokë. Do të shohë raportet dhe përmasat në dimesione të fytyrës e të gjithë të dhënat e tjera, formën e syve e të tjera me rradhë. Sigurisht që ka një marzh gabimi, ne do ta gjejmë patjetër, por ajo që doja të thoja është që minimumi, apo maksimumi i këtij marzhi gabimi do të duhet të jetë kërkesë e specifikimeve teknike që do të bëjmë për këtë platformë. Është njësoj sikur të themi që ne do të duam një platformë që ta ketë marzhin e gabimit jo më shumë se 2% apo 1%...

Z. M. Çakaj: 2 %?! 2 % është shumë...

Znj. J. Josifi: Thashë një numër, nuk është një.., dua të them që vendoset një konvencion, i cili...

Znj. I. Nano: Atëherë, pyetje të tjera kemi? Atëherë, unë kam një propozim nuk e di ka nga partitë politike? Unë kam një propozim që në pikën 7 të shtohet një fjali e dytë. Pika 7 aktualisht është propozuar “Në listën përfundimtare të zgjedhësve do të përfshihen ata zgjedhës të cilëve u është pranuar kërkesa për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Unë propozoj të shtohet edhe kjo fjali: “Pavarësisht se zgjedhësi ka emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve, e drejta e votimit do të realizohet në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 105, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor si dhe në aktet e tjera të Komisionit Rregullator për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

votimin nga jashtë”. Propozime të tjera kolegë, kemi? Të kaloj në votimin e këtij propozimi pastaj të Kreut IV në tërësi? Zonja Josifi, po!

Znj. J. Josifi: Thjesht një detaj te pika 6 që në fakt tani e kapëm edhe ne. Themi: “Zgjedhësi të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim mund ta ripërsërisë kërkesën pa asnjë kufizim në herë deri në orën 24:00 të datës së fundit kur lejohet paraqitja e kërkesave për regjistrim në PER”. Në këtë rast kemi veçantinë që zgjedhësit nga jashtë vendit i kemi me orare të ndryshme nga atje. Pra, ora kur ai e bën kërkesën është tjetër nga ora këtu. Do të duhet të vendosim shënimin “sipas orës shqiptare”.

Znj. H. Vukaj: Po, por do të jeni diskret pozitiv, e do të thoni “mjafton që të jetë 24 e orës së tyre”.

Znj. I. Nano: Mund të jenë në lindje, apo në perëndim të Shqipërisë dhe për dikë është...


Z. M. Çakaj: Të thuhet 24:00 me orën shqiptare.

Znj. I. Nano: Sipas orës së Shqipërisë.

Z. M. Çakaj: Në rregull, po si do të realizohet teknikisht kjo? Dakord e vendosëm ne me orën shqiptare, atëherë mund ta bëjmë këtë teknikisht psh?

Znj. J. Josifi: Do të sinkronizojmë orën në platformë dhe orën time zonë në Shqipëri.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Pra, në çdo rast ora do të marrë orën shqiptare.

Znj. J. Josifi: Po, pas atij momenti nuk do të lejojë që të paraqiten kërkesa sipas pikës 6. Pra, do të thotë afati ka skaduar nuk është e mundur, sepse jemi jashtë afatit.

Znj. I. Nano: Pra, sinkronizimi i orës?

Znj. J. Josifi: Po.

Znj. I. Nano: Atëherë, këtu do të shtojmë "... sipas orës së Shqipërisë", ose do ta gjejmë termin dhe kemi për të votuar propozimin që sapo bëra unë për të shtuar një fjali në pikën 7 të këtij kreu.

Kolegë kush është dakord me këtë pikë?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, kalojmë për votim të gjithë Kreun IV.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kreu V.

A mundet të bëjmë vetëm 5 minuta pushim, ju lutem? Meqenëse unë kam lexuar kaq shumë, të pushojmë 5 minuta.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Rifillon mbledhja

Ora, 18:40

Znj. I. Nano: Atëherë, vazhdojmë me Kreun V. Përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, mënyra dhe afatet e komunikimit me RKGjC, si dhe modalitetet e rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

Më lejoni kolegë dhe pjesëmarrës të mos e lexoj këtë kre nga fillimi në fund, sepse është i njëjti propozim që e keni marrë dy ditë më parë nga ana e Komisionerit, që e kemi marrë zyrtarisht. Deri tani nuk ka pasur, edhe në aktin e parë që kemi marrë në shqyrtim, deri tani nuk ka pasur ndonjë propozim konkret. Kështu që unë do të pyes tani kolegët dhe përfaqësuesit e partive politike, nëse kanë propozime për këtë kre, para se të kalojmë në votim.

Kolegë, kemi diçka? Nuk ka!

Kalojmë në votimin e Kreut V!

Kush është dakord? Kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!


Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë tek Kreu VI.

Unë do ta lexoj, pasi nga... Kreu VI është: Mbikqyrja dhe kontrolli i procesit. Të gjithë e kanë draftin, por deri tani mua më ka ardhur një propozim i shkruar nga kolegët, kështu që po lexoj.

Pika 1. Auditët teknicienë të miratuar sipas nenit 61, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit, pa kufizim në drejtim të ngritjes së pyetjeve e kërkesave

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

për verifikim, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit të Komisionit Rregullator për zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit.

2. Partitë politike, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe të medias, në kuadër të transparencës dhe informimit, kanë të drejtë të njihen me të gjithë elementët e PER, veçanërisht gjatë proceseve të: testimit paraprak operacional, kontrollit apo auditimit të saj, si dhe kanë të drejtën për t'u njohur dhe për të marrë pjesë në testime gjatë procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Pika 3. Me kërkesë të partive politike, ose kryesisht KQZ, mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara.

Kemi diçka?


Znj. H. Vukaj: Ndoshta do t'i rrinte më mirë pikës 3, në fund të fjalisë të shtojë "në çdo fazë".

Znj. I. Nano: Kur flasim për auditim...

Znj. H. Vukaj: Meqenëse i referohemi me kërkesë të partive politike, që normal janë subjektet të cilat duhet të binden, duhet të kenë besueshmërinë të kjo platformë, ose kryesisht mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara në çdo fazë.

Znj. I. Nano: Dakord, ky është propozim. Atëherë kolegë, kemi ndonjë propozim tjetër? Nga partitë politike? Jo!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Po e përfshij të gjithë kreun me propozimin e zonjës Vukaj “në çdo fazë”.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kreu VII. Dispozita të fundit.


1. Ngarkohen administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kolegë?

Z. M. Çakaj: Sapo e diskutuam dhe me kolegen Vukaj, te pika 1, duke qenë se i lamë dhe detyra konkrete edhe nga mbledhja Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do të sugjeroja që të përfshihet edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në ngarkimin nga ky akt, edhe nga detyra që i ngarkon në fakt, Kodi Zgjedhor, për të vijuar me procesin. Pra, riformulimi.., se administrata është vetëm administrata. ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ dhe institucionet e ngarkuara me detyrë nga ky vendim për zbatimin e tij. Pra, se i kemi lënë detyra konkrete.

Znj. I. Nano: Edhe administrata, se mendova se do ta hiqnit administratën.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

Z. M. Çakaj: Jo, jo edhe administrata. Pra Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim. Në rastin konkret DPGjc-ja, ose Ministri i Brendshëm për atë urdhërin e përbashkët, me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij.

Znj. I. Nano: Dakord! Kalojmë në votimin e Kreut VII. Dispozita të fundit, me ndryshimin e propozuar nga zoti Çakaj në pikën 1?

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit!

Pasi është votuar në parim, është votuar nen për nen. Kolegë,

Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?


Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Përpara se do t'i jap fjalën zotit Çaka që e ka kërkuar, unë do të doja në përfundim të shqyrtimit të këtij akti, të falenderoja të gjithë ata që kanë kontribuar. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuesit e partive politike, por edhe shoqërinë civile dhe veçanërisht shoqatat e diasporës të cilat kanë qenë të angazhuara maksimalisht në këtë proces. Jo vetëm kanë qenë të interesuara, por kanë qenë të angazhuara konkretisht me sugjerime, me pjesëmarrje në konsultime. Ne së fundmi sot kemi marrë dhe një email nga një prej këtyre organizatave. Për të mbyllur falenderimet do të vijojmë me diskutimin për të nesërmen. Kur them të nesërmen,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*


që nesër në kuptimin e ditës së enjte dhe më tej. Sikundër e pamë në këtë proces, kërkohet një konsultim i gjerë, prandaj unë do të kërkoja nga ana juaj, zonja Çelmeta, zonja Josifi, që nëse keni akte të tjera të përgatitura nga ana e administratës të fillojë procesi i konsultimit sa më shpejt. Në rastin e aktit të rradhës, që unë e mendoj se janë dokumentat që ne do t'i miratojmë me një akt të veçantë të Rregullatorit, sikundër e parashikuam. Pra, dokumentat për të vërtetuar adresën e banimit të shtetasit jashtë vendit. Në konsultimin e parë që ka nisur për këtë akt, ato kanë qenë pjesë. Pra, mendoj që duhet shumë shpejt dhe më pas akti për votimin. Pra, nëse paketën nuk e kishim që në fillim, tani t'i kemi një pas një aktet dhe sa më shpejt se pa dyshim e pamë që ka nevojë për konsultim. Faleminderit! Zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Nano! Unë ashtu siç dhe e nisa në fillim të shqyrtimit të akteve, nuk do të doja që të zgjatesha më shumë se pak a shumë është i njejtë vlerësim që dhe ju bëtë ndaj një kërkesë të administratës për të vazhduar sa më shpejt me aktet vijuese për të përmbyllur të gjithë këtë cikël dhe në respektim të afateve që na ka vendosur Kodi Zgjedhor. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Shumë shkurt! Doja t'i adresohesha të gjithë shtetasve shqiptarë të interesuar për këtë proces, për të cituar edhe njëherë që ky është një akt gur themeli, apo gur kilometrik në të gjithë rrjetin e akteve që do të krijohen e do të vijnë pas tij. Ndaj dhe ju me të drejtë i bëtë thirrje administratës dhe Komisionerit në të njejtën kohë që të nxitojë dhe të ecë me ritmin e shqetësimit tonë, por edhe të afateve të cilat janë duke u tkurrur për ditë. I ftoj të gjithë shqiptarët që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë, të regjistrohen masivisht, sepse vërtet është një çelje historike e një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 23.10.2024*

procesi i cili uroj siç e kam cituar që në krye të herës, të jetë ogur i mirë dhe sukses në këtë proces tridhjetë vjeçar. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Atëherë edhe diçka për administratën. Duke qenë se sot është orë e vonë dhe keni qëndruar jo pak jashtë orarit, brenda ditës së nesërme të zbardhet vendimi. Propozimet që kanë ardhur me shkrim ne do t'jua dërgojmë që ta keni më lehtë. Propozimet që janë bërë në seancë besoj se i zbardhni dhe i vendosni aty ku janë miratuar. Meqenëse nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës, apo jashtë rendit të ditës, për të diskutuar, unë dëshiroj ta mbyll mbledhjen, natën e mirë!

Vendimi nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

